

**VENDIM**  
**Nr. 6, datë 23.1.2013**

**MBI ANKANDIN E MUAJIT SHKURT 2013 TË KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “ç” paragrafi “ii” dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 7 germa “b” të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 924, datë 26 dhjetor 2012 ka vendosur “Lejimin e shoqërisë KESH sh.a., të importojë energji elektrike për periudhën 1.1.2013 deri 1.3.2013 për furnizimin e konsumatorëve tariforë dhe mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes”, si dhe kapitullit X pika 2 të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike të miratuara nga ERE me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 23.1.2013, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut

**VENDOSI:**

1. OST sh.a. t’i alokojë me të drejta të siguruara pa pagesë, shoqërisë KESH sh.a., kapacitetet ndërkufitare të interkonjeksionit për muajin shkurt 2013, në drejtim importi, për kryerjen e importit të energjisë elektrike për furnizimin e konsumatorëve tariforë dhe mbulimin e humbjeve në sistem.

2. OST sh.a. të zhvillojë ankand për muajin shkurt 2013 për kapacitetet e mbetura ndërkufitare, në drejtimin e importit, pas plotësimit të pikës 1 të këtij vendimi.

3. OST sh.a. të zhvillojë ankandin për muajin shkurt 2013 për kapacitetet ndërkufitare në drejtim eksporti.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**